

Numri i lëndës: 2023:302873
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05516129

C.nr.154/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në V., Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Alush Sinani dhe bashkëpunëtoren profesionale Adelina Ajeti, në çështjen juridike kontestuese të paditëses V.D., nga fshati R., Komuna e V., të cilën e përfaqëson me autorizim M.H., avokate nga V.a, kundër të paditurës Komuna e V. – Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti: kompensimin e ushqimit dhe udhëtimit, me vlerë të kontestit prej 672.3€, jashtë seancës, më datën 18.03.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V.D., nga fshati R., Komuna e V., detyrohet e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna e V., që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit ditor për periudhën 03.06.2021 deri më datën 22.11.2022, për 249 ditë pune t'ia paguajë shumën në lartësi prej 498€, si dhe për shpenzimet e udhëtimit për të njëjtën periudhë, për relacionin R. - V. dhe anasjelltas, t'ia paguaj 70% të biletës së trafikut urban, në shumë prej 174.3€, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 672.3€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e parashtimit të padisë deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit.

II. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Ar sy e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarës së saj me datën 28.12.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit-Komuna e V., ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna e V., që t'ia paguaj paditëses shumën e përgjithshme prej 672.3€ në emër kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë. Padisë ja ka bashkangjitur : Vërtetimi mbi përvojën e punës dhe ditëve të punës; Kërkesa e paditëses; Certifikata e vendbanimit; Cmimorja e biletave.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për taksën gjyqësore, për përpilimin e padisë, dhe për përfaqësimin në seancë gjithsej shumën e përgjithshme prej 124€.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, duke arsyetuar se DKA nuk ka kompetencë ligjore sipas Ligjit për Financa Publike të bëj pagesë për destinim nga buxheti komunal. E njëjta ka shtuar se pagat paguhen nga niveli qendror – Ministria e Administratës Publike e Financave dhe e Arsimit, andaj si DKA nuk kemi asnjë obligim lidhur me pretendimet e paditëses. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare, pra gjendjen faktike, siç janë ekzistimi i marrëdhënies së punës, përvoja e punës si dhe lartësia e pagës, paditësja ka qenë e pranishme në punë 249 ditë andaj ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara konform nenit 398 të LPK-së.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të padituritë, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune tek e

paditura.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses dhe lartësisë së tij, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, dhe 22.01.2021, konkretisht nenin 35 paragrafi 5 dhe 7 të kësaj Kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi. Konkretisht në nenin 35 paragrafi 5 të kësaj Kontrate ku thuhet se “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimin e Komunës përkatëse ku punojnë i paguhet shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”, si dhe paragrafin 7 ku thuhet se “Të punësuarve (anëtarët e SBASHKU-it) i sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë punë është (2) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restauronit a kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”, andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata e aprovoi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017, dhe 22.01.2021, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të, si dhe duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017, dhe 22.01.2021, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ Ligji nr. 04/L-077 datë 19.06.2012

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë në shumën prej 104.00 € dhe taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20.00 €, e në shumën e përgjithshme prej 124€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË V.,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr. 154/2024, më datë 18.03.2024

G j y q t a r i,
Alush Sinani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.